



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo/ Republic of Kosovo**  
**Këshilli Prokurorial i Kosovës/ Tužilački Savet Kosova/Kosovo Prosecutorial Council**  
**Sekretariati / Sekretarijat / Secretariat**

---

Në bazë të nenit 31 të Ligjit Nr.06/L-056 për Këshillin Prokurorial të Kosovës, nenit 19 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 08/L-167 për Prokurorin e Shtetit, nenit 16 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, nenit 4 të Rregullores Nr. 03/2022 për Praktikantë në Sistemin Prokurorial dhe Aktgjykimin të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës A. Gj. 1583/20 të datës 09 korrik 2020, lidhur me procedurën për rekrutim të praktikantëve vullnetarë pa pagesë, për periudhën një (1) vjeçare në sistemin prokurorial të Kosovës, Sekretariati i Këshillit Prokurorial të Kosovës, shpallë këtë:

**V A Z H D I M I I K O N K U R S I T**  
**Nr. 04/2023**

Për praktikantë vullnetarë pa pagesë, për periudhën një (1) vjeçare, si në vijim:

Nr.	NJËSIA	Numri i Praktikantëve
1.	Prokuroria Themelore Prishtinë	5
2.	Prokuroria Themelore Gjakovë	10
3.	Prokuroria Themelore Ferizaj	10
4.	Prokuroria Themelore Gjilan	10
5.	Prokuroria Themelore Mitrovicë	5
	<b>GJITHSEJ:</b>	<b>40</b>

**Detyrat kryesore të praktikantit/es:**

- Ndhmon prokurorët si dhe stafin e sistemin prokurorial në kryerjen e detyrave si dhe kryen punë të tjera në koordinim me zyrtarët e prokurorisë dhe Sekretariatit të KPK-së.
- Përbahet rregullave të brendshme të sjelljes, duke përfshirë por duke mos u kufizuar në vijueshmëri, orarin e punës, kodin e veshjes dhe konfidencialitetin.
- Në përputhje me legjislacionin në fuqi duhet të gëzojnë të drejtën për pushim ditor, pushimin vjetor, festat zyrtare dhe mbrojtjen nga orët e tepërta të punës.
- Praktikanti duhet të ketë mundësinë që të aftësohet në aspektin profesional në kuadër të detyrave dhe përgjithësive të cilat i janë ngarkuar.
- Përgatitjen e raportit gjashtë mujor dhe në fund të praktikës, ose sipas kërkesë së mbikëqyrësit me angazhimet e kryera.
- Kryen edhe detyra tjera të caktuara nga prokurori dhe zyrtarët e sistemit.

- Përrjashtimisht praktikantët të cilët janë të fushave tjera, siç janë praktikant në financa, teknologji informative, administratë, burime njerëzore si dhe shërbime të tjera të përgjithshëm detyrat përcaktohen nga udhëheqësit e njësive përkatëse brenda Prokurorit të Shtetit dhe në Sekretariatit e KPK-së sipas nevojës.
- Për punën e tyre praktikantët në Sekretariat mbikëqyren nga udhëheqësit e njësive, ndërsa në prokurori nga administratori i prokurorisë.

#### **Kualifikimi:**

- Diplomë Universitare të Fakultetit Juridik.

#### **Aftësitë dhe Shkathtësitë e kërkua:**

- Njohuri të procedurave administrative etj;
- Aftësi për përgatitjen e akteve juridike;
- Aftësi të punës me kompjuter;
- Shkathtësi komunikimi.

#### **Dokumentet për aplikim:**

- Kopjen e letërnjoftimit;
- Diploma apo certifikatë universitare;
- Certifikata e gjendjes penale.

#### **VËREJTJE:**

- Konkursi është i vazhduar tetë (8) ditë nga dita e shpalljes së lajmërimit më datën: **01.12.2023** dhe mbyllet me datë **08.12.2023**.
- Kandidatët praktikantë duhet të plotësojnë formularin standard për aplikim që është dispozicion në ueb faqen e KPK-së: [www.prokuroria-rks.org](http://www.prokuroria-rks.org).

#### **Forma e aplikimit:**

- Aplikacionet dorëzohen çdo ditë pune nga ora 08:00 deri në ora 16:00 në Sekretariatit e Këshillit Prokurorial të Kosovës/Divizioni i Burimeve Njerëzore kati IV, Rr. "Luan Haradinaj", Objekti i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, 10000 Prishtinë
- Aplikimi përmes postës: Kërkesat e kompletuara me dokumente mund të dorëzohen edhe përmes postës në Divizionin e Burimeve Njerëzore të Sekretariatit të Këshillit Prokurorial të Kosovës, adresa: Rr. "Luan Haradinaj" objekti i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës.
- Aplikacionet pas skadimit të afatit të konkursit të lartë cekur nuk pranohen.